



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E SHËRBIMIT PYJOR, BUJQËSISË, MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Sektori i Administrim-Menaxhimit

Nr. 2088 / Prot.

Gramsh, më 21.06. 2021

Lënda : **Dërgim Informacioni.**

Drejtuar : **Znj. Fatbardha NERGJONI**

Adresa : Hotel Turizmi Skampa

ELBASAN

Në përgjigje të kërkesës Tuajës nr.335, datë 07.06.2021 "Kërkesë për informacion", e protokolluar në Bashkinë Gramsh me NR.REGJ.2088, datë 08.06.2021, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh, bazuar në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet", në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/Bashkive" i ndryshuar, të VKM-së nr.438, datë 08.06.2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera drusore e jodrusore", si dhe në zbatim të Udhëzimit nr.2, datë 03.03.2017 "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grup ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime, me preje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje", ju informojmë si më poshtë vijon ;

1. Numri i kontratave/ anek-kontrakave që ka lidhur Bashkia Gramsh me subjektet juridike/fizike për vitin pyjor 2020-2021 dhe që janë aktive është 4 (katër). Janë 2 (dy) kontrata konçesioni të vitit 2008 dhe vitit 2011 të fituara me ankand nga subjekti juridik "AlMex Wood" shpk, ndërsa 1 (një) kontratë është për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë nga materiali drusor të dalë përgjatë traseve të linjave elektrike të TM-Nënstacioni Gramsh ku aktivitetin e shfrytëzimit e zhvillon subjekti juridik "Kurora" shpk & subjektin fizik "Ruzhdie Jança" të fituar në ankand, dhe 1 (një) kontratë është për shfrytëzimin e lëndës drusore të përfituar nga materiali drusor të vlerësuar në ngastrat pyjore të dëmtuara nga faktorët të ndryshëm natyrore dhe nga zjarret ku aktivitetin e shfrytëzimit e zhvillon subjekti juridik "Kopaçi" shpk të fituar në ankand.

2. Gjatë zhvillimit të aktiviteteve të shfrytëzimit të pyjeve (ngastrave e nënngastrave pyjore) nga institucionet, banorët e zonave apo dhe nga firmat shfrytëzuese ku zhvillohet ky aktivitet nuk kemi patur ankesa.

3. Për çdo shkelje ligjore që është vërejtur gjatë zhvillimit të aktivitetit të shfrytëzimeve nga ana e personelit pyjor është mbajtur qëndrim ligjor sipas kuadrit ligjor në fuqi.

4. Aktiviteti i shfrytëzimeve zhvillohet sipas studimeve duke zbatuar Planet e Mbarështrimit/Menaxhimit të ekonomive pyjore dhe miratohen nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit mbi mundësinë vjetore të vjeljes së materialit drusor.

5. Nuk ka vendim specifik nga Këshilli Bashkiak për pyllëzim, zëvendësime të zonave problematike por Bashkia Gramsh ka planifikuar fonde për pyllëzime në disa zona problematike (pyllëzime në ngastrat e nënngastrat pyjore/kullosore që janë të djeguara ndër vite).

6. Sipërfaqja pyjore e ngastrave e nënngastrave pyjore që janë në aktivitet shfrytëzimi në Bashkinë Gramsh është 134 ha.

Duke J'u falenderuar për mirëkuptimin.

KRYETARI

Klodian TAÇE



Konceptoi: Ing. B. Coha

Pranoi: Ing. F. Lleshi

Miratoi: A. Shuli

Konfirmoi:

Dosja nr: _____

Afati i ruajtjes: